



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË  
MBAJTUR MË 10.03. 2011

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE  
10.03. 2011. GODINE

MARS – MART  
2011

**E enjte, më 10. 03. 2011,**

**Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 90 deputetë, andaj fillojmë me punën e mbledhjes plenare.

Ju njoftoj se në pajtim me nenin 15, paragrafi 3 dhe neni 42 të Rregullores së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentar ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Të nderuar deputetë,

Propozoj që votimi i Projektrezolutës të radhitet si pikë e fundit e rendit të ditës.

Na duhet një votim formal. Kush është “për”? Faleminderit! Kush është “kundër”? Faleminderit! Shumica janë “për”, do të thotë, votimi për projektrezolutën radhitet si pikë e katërt e rendit të ditës.

Tani procedojmë me rendin e ditës.

Pika e parë e rendit të ditës është:

### **1. Deklarimet jashtë rendit të ditës**

Në pajtim me nenin 47 të Rregullores së Kuvendit, koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimet në emër të grupit parlamentar zgjatin deri në 5 minuta, ndërsa diskutimet e deputetëve deri në 3 minuta.

Andaj, kërkoj nga deputetët e paraqitur për diskutim që të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën, edhe pse është mirë deputetët që lajmërohen për këtë pikë të rendit të ditës ta lexojnë Rregulloren e Punës dhe paraqitjet t’i bëjnë në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit.

Fjalën e ka deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: I nderuar kryetar,

Kryeministër, zëvendëskryeministra,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Para tri ditësh, në rrethinë të Gjilanit, në rrethana të paqarta është vrarë një i ri, një djalë i moshës së re i një familjeje të varfër dhe ka shkaktuar dhimbje jo vetëm në familje, por te të gjithë qytetarët atje dhe në Kosovë. Raste të ngjashme, siç e dini, më parë kanë shkaktuar jo vetëm tensione, por edhe trazira. Dëshiroj që t’ju them që raste të tilla po ashtu shfrytëzohen edhe ka mundësi të shfrytëzohen edhe për qëllime të ndryshme. Shfrytëzoj praninë edhe të kryeministrit edhe të Qeverisë që të kërkojë që institucionet përkatëse: Ministria e Punëve të Brendshme dhe ajo e Drejtësisë, sa më shpejt të dalin me sqarime zyrtare dhe me rezultatet e

hetimeve, në mënyrë që sa më shpejtë kryesit e këtij akti të dalin para drejtësisë. Po ashtu, inkurajoj gjithë atë që janë solidarizuar me këtë familje edhe kryetarin e Kuvendit Komunal të Gjilanit, i cili po ashtu ka qenë afër familjes në çastet e para dhe po ashtu shpresoj që edhe udhëheqësit lokal të komunave, të komunës së porsaformuar, në kuadër të së cilës janë këta banorë të cilët e kanë kryer, supozohet që e kanë kryer aktin, të punojnë sa më shumë, në mënyrë që akte të tilla, të krijohet një atmosferë më e favorshme edhe në kohën kur, siç e dini, te ne po zhvillohen aktivitete të rëndësishme shtetëformuese për vendin.

Pra, kërkoj një angazhim më të madh dhe mobilizim edhe të funksionarëve ose të përgjegjësve lokalë të komunës së Parteshit dhe po ashtu një bashkëpunim më të mirë të komunave ndërmjet veti. Po, ajo që na duhet, është një version zyrtar dhe informata më të shpejta nga institucionet zyrtare të hetimit dhe të drejtësisë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar deputeti Haki Demolli.

**HAKI DEMOLLI:** I nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2007, kryeministri i tanishëm i Qeverisë së Kosovës, zoti Thaçi, përveç të tjerash i ka premtuar popullatës së Kosovës edhe furnizim me rrymë elektrike, 24 orë në ditë.

Tash kur po bëhen 4 vjet, në krye të Qeverisë së Kosovës, që është zoti Thaçi, do t'ia bëja një pyetje lidhur me këtë çështje. A është përmbushur premtimi i kryeministrit për furnizim me rrymë elektrike 24 orë në ditë? Në vend të tij do të përgjigjem vetë. Me një slogan të partisë së tij: Hashim Thaçi premtoi, nuk e realizoi, dështoi. Gjendja në këtë rrafsh është tejet e rëndë, sepse furnizimi është duke u bërë sipas ndarjes së qytetarëve në tri kategori: A, B dhe C. Kjo mënyrë e furnizimit është e kundërligjshme dhe diskriminuese. Furnizimi sipas kategorive A, B dhe C është i kundërligjshëm, sepse si qytetarë të Republikës së Kosovës kemi lidhur me KEK-un kontrata individuale mbi furnizimin e jo kontrata kolektive. Andaj, edhe shkyçja apo reduktimi duhet të bëhet në mënyrë individuale prej rastit në rast, varësisht nga mospagesa apo keqpërdorimi eventual i rrymës e jo në mënyrë kolektive.

Furnizimi i tillë është edhe diskriminues, sepse distributori i rrymës- KEK-u e ka ndarë popullatën në kaste apo në rangje, thua se ne jemi popullatë e ndonjë shteti të pazhvilluar të Afrikës apo Azisë. Çdo shtetas i Kosovës që gjendet në kategorinë C, njëri ndër ta jam edhe unë personalisht dhe banorët e lagjes ku jetoj unë, e ndijnë veten të fyer dhe të diskriminuar. Kam përshtypje se në rastin e Kodrës së Trimave, prej nga vijë në këtë Kuvend, në pyetje është jo simpatia, për të mos thënë diskriminimi i pushtetit ndaj banorëve të kësaj zone të kryeqytetit.

Banorët e Kodrës së Trimave kanë qenë të padëshirueshëm edhe për pushtetin e mëparm, sepse ka qenë lagje e banuar me mbi 99% shqiptarë, ka zhvilluar shumë demonstrata dhe protesta kundër ish regjimit, ka pasur shumë shtëpi - shkolla, ka pasur shërbimin mjekësor të shoqatës "Nënë Tereza", përfshirë edhe gjinekologjinë, ka strehuar shumë të zhvendosur të luftës 1998-1999.

Dhe, tani, në kohën kur po ndërtojmë një shtet demokratik jo vetëm që u harruan sakrificat e banorëve të Kodrës së Trimave, por përkundrazi serish jemi delja e zezë e pushtetit, serish jemi të padëshiruar për pushtetin, sepse në këtë zonë nuk ka mundur të fitojë subjekti politik që është në pushtet, por ka fituar LDK-ja.

Dua të shtoj se jo vetëm banorët e Kodrës së Trimave, por edhe vendbanimet tjera ku ka fituar më shumë vota opozita, janë të ranguar në kategorinë C. I tillë është rasti i Kastriotit, të cilët dje patën një protestë, siç e pamë të gjithë, pastaj të Artanës dhe të vendbanimeve tjera.

Andaj, kërkoj prej Qeverisë së Kosovës që sa më parë të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme, qoftë përmes Rregullatorit të Energjisë Elektrike, anëtarët e Bordit të cilët i propozoi Qeveria, qoftë për...

**KRYETARI: Faleminderit!**

Neni 47 i Rregullores - Deklaratat e deputetëve, përkatësisht të grupeve parlamentare për çështje që nuk janë në rend të ditës, mund të diskutohet për çështje të ndryshme që i konsiderojnë se duhet të bëhen publike në mbledhje plenare. Për çështje që mund të hynë në rend të ditës dhe janë probleme të një rëndësie të veçantë, unë mendoj që duhet të bëhen kërkesa te grupet parlamentare për t'u diskutuar disa çështje. Pyetjet parlamentare janë pyetje e veçantë dhe nuk mund të bëhen në këtë pikë të rendit të ditës. Prandaj, po kërkoj që vërtet ta respektojmë Rregulloren. Nuk është pyetje, unë mendoj që edhe deputetët që e marrin fjalën të diskutojnë për këtë pyetje, duhet ta kenë të qartë se për çka janë këto deklarime.

Vazhdojmë me rendin e ditës. Mund ta keni pjesën e juaj të veçantë, kryeministër, në fund pasi ta kryejmë 30 - minutshin, Qeveria mund ta ketë 30- minutëshin e vet. Fjalën e ka kërkuar deputeti Visar Ymeri.

**VISAR YMERI: Kryetar i Kuvendit të Kosovës,**

**Të nderuar deputetë,**

Unë sot po e mbaj fjalën në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”. Edhe unë do të flas, siç foli deputeti Zenun Pajaziti, për vrasjen e Leutrim Musliut, në fshatin Uglar, të shtunën, mirëpo për dallim prej Zenunit, unë konsideroj që kjo vrasje ishte akt kriminal e jo ndonjë aksident, siç e përshkruajti ky.

Leutrimi u vra nga strukturat ilegale të shërbimeve të kundërzbulimit të Serbisë. Ky është një akt tejet kriminal, për të cilin është përgjegjës Serbia dhe strukturat e saj në Kosovë.

Dy të dyshuarit për këtë vrasje janë në arrati dhe është tejet e vështirë të paramendohet nëse ata do të arrestohen ndonjëherë nga Policia e Kosovës. Ka shumë gjasë që ata kanë ikur për në Serbi dhe janë bërë bashkë tash me kriminelët tjerë atje që kanë vrarë, plaçkitur e dhunuar në Kosovë, e të cilët enden të lirë nëpër qytetet e Serbisë.

E keni parë nga raportimet mediale se gjatë bastisjes që e ka kryer policia atje në shtëpitë e dy të dyshuarve, ka gjetur një arsenal të madh të armëve të ndryshme dhe kjo, fatkeqësisht, kaloi pa ndonjë shqetësim të madh të institucioneve ekzekutive të Kosovës.

Ndërkohë që në anën tjetër të Kosovës, në komunën e Albanikut, ish Leposaviqit, po të njëjtat struktura kanë filluar tash e sa kohë protestat e përditshme kundër pranisë së policisë së trafikut të Kosovës, në atë pjesë të vendit. Këto bllokime të rrugëve janë të organizuara nga strukturat paralele dhe nuk kanë asgjë të bëjnë me ndonjë mllef spontan të qytetarëve serbë të Kosovës.

Zaten, para dhe gjatë çdo procesi negociator me Serbinë, kjo e fundit përherë është përkujdesur që ta mbajë situatën në terren në këmbë, në mënyrë që ta përdorë atë si levë negociatash. Pra, e shihni se si po përkujdeset Serbia që të tregojë se është e pranishme edhe në pjesë tjera të Kosovës e jo vetëm në veri. Këtë tregim tash së fundi e bëri përmes vrasjes së Leutrimit. Dhe, po e shihni se si po na thotë se nuk do ta pranojnë shtetin e Kosovës në veri përmes protestave të organizuara atje. Pra, njëjtë siç kanë bërë në Bosnjë, para dhe gjatë luftës.

Gjendja e sigurisë në Kosovë po përkeqësohet për çdo ditë. E çfarë po bën Qeveria e Kosovës për këtë? Ata po negociojnë me Serbinë. Pra, po negociojnë pikërisht me këtë shtet përgjegjës për këtë përkeqësim të gjendjes së sigurisë dhe për këtë vrasje kriminale të Leutrimit. Përkundër asaj që u tha në Kuvendin e Kosovës, në seancën e së hënës, përkundër krimeve të vazhdueshme të Serbisë ndaj qytetarëve të Kosovës, përkundër këtyre krimeve të fundit që ndodhën ndaj qytetarëve të Kosovës, kjo qeveri po e vazhdon procesin negociator me kërkesë të Serbisë dhe sipas interesave të Serbisë.

Po të ndodhte një krim i tillë, ku viktima do të ishte pjesëtar i pakicës kombëtare serbe në Kosovë, Serbia do ta ngriste këtë çështje deri në Këshillin e Sigurimit. Po, meqenëse Leutrimi është shqiptar, askush nuk merret me të. Kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçit, kjo çështje nuk i bëri fare përshtypje. Ai madje nuk e mori as mundimin ta ngushëllojë familjen, e lërë më të bëjë diçka më shumë. Pra, kjo tregon se çfarë përgjegjësie ndjen ky person i ulur këtu pas meje, për jetën e qytetarëve të Kosovës dhe cilësinë e jetës së qytetarëve të Kosovës. Duket që për kryeministrin Hashim Thaçi, Kosovë është vetëm Prishtina, madje edhe më keq, vetëm ky objekt ku jemi këtu, ndërkohë që si qytetar i Kosovës duket se ky e konsideron vetëm veten. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, ndoshta në emër personal, replikë. Në këtë pikë s'ka replikë. Më falni shumë! Deputeti Daut Haradinaj e ka fjalën.

**DAUT HARADINAJ:** Ju faleminderit!  
I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Përpjekjet tona për shtet nuk kanë qenë të lehta. Ato lanë shumë pasoja të cilat duhet zgjidhur, por a mund të zgjidhen këto pasoja me një lidhshmëri çfarë e kemi sot? Dhe, unë them – jo! Kosova sot po përballlet me shumë sfida të brendshme, me një udhëheqje të minorancës shqiptare, me një imazh të shkatërruar ndërkombëtar nga po këta njerëz që sot shkojnë në dialog, me një ekonomi që po shkon drejt shkatërrimit nga korrupsioni qeveritar, me një qeveri të hetuar nga miqtë tanë ndërkombëtar, me politika ekonomike shpenzuese dhe jo krijuese, të cilat e kanë degraduar Kosovën dhe përgjegjësi i të gjitha këtyre, sot po negocion. Me kontroll të kufizuar të rendit dhe ligjit në tërë Kosovën, me krim të organizuar fetar e ndërkombëtar, që veç është bërë pjesë e Qeverisë sonë, andaj me të drejtë mund të themi se shkuarja në negociata në këto rrethana do ta dëmtonte edhe më shumë Kosovën dhe popullin e saj, dëme këto që vështirë do të riparohen.

Ne duhet të kemi një marrëveshje të brendshme, e cila do të pajtohej në të gjitha nivelet, qofshin ato politike apo jo politike, do të krijoheshin grupe ekspertësh të cilët do ta hartonin strategjinë e palës kosovare, do të vireshin vijat e kuqe që nuk do të negocioheshin, vija këto që, zoti kryeministër, janë larë me gjak për vite me radhë.

Brenda ekipit të Kosovës të përfshihen njohësit më të mirë të skenës politike vendore dhe ndërkombëtare. Ne nuk mund të sillemi me komoditet karshi një situatë të tillë, ku top-lajm i botës jemi bërë me afera prej më të ndryshmet, ndër më të këqijat që ka pasur Kosova pas luftës dhe emëruesi i përbashkët janë po këta njerëz që sot janë në krye të vendit.

Shoqëria kosovare është e bindur në rrugën euroatlantike, por kjo rrugë nuk shkohet drejt Beogradit.

Të nderuar përgjegjës të kësaj situatë, ju do të mbani përgjegjësinë historike për dëmet që do t'i sjellin këto biseda të dyshimta që nuk janë prioritet i popullit të Kosovës, por të atyre që negociojnë tash e sa vite, pa i dhënë llogari këtij populli. Kosova dhe populli ynë, me vlerat që posedon, asnjëherë dhe në asnjë rrethanë nuk ka dashur dhe nuk ka kërkuar atë që nuk i takon, andaj sot, të nderuar deputetë, ju me votën tuaj, mund t'i thoni kësaj te keqe – jo! Mund t'i themi - po çdo partneriteti me shtetet fqinje, por jo agjendave që janë në dëm të vendit.

Kosova më 17 shkurt ka shpallur pavarësinë e vet. Kushtetuta e Kosovës u garanton të gjitha të drejtat qytetarëve, pa dallim, dhe ne nuk kemi çka të japim më shumë. Kosova nuk rrezikohet vetëm nga jashtë, Kosova rrezikun e ka brenda dhe ky rrezik po legjitimohet me dialogun që po dëshirojnë ta bëjmë në kohën kur veriu nuk kontrollohet nga shteti i Kosovës. Pikat e kuqe vendosen në këto salla dhe jo diku tjetër.

Të njëjtën kohë, i nderuar kryetar, dëshiroj t'i shpreh ngushëllimet familjes së Leutrimt dhe të bashkohem me dhembjen e tyre. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryetar i Parlamentit,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Desha ta sqaroj një çështje, e cila ka të bëjë me lëvizjen “Vetëvendosje”, është çështje që ka kaluar goxha një kohë, mirëpo ta shfrytëzoj rastin në këtë 30 minutësh të ngre.

Për zgjedhjet e 23 janarit në Mitrovicë, në gazetën “Zëri”, të cilën e posedoj këtu me vete, në shtojcën e fletushkës “Vetëvendosje”, thuhet: “Në shkollën “Skenderbeu”, vëzhguesit e PDK-së qëllimisht kanë grumbulluar nëpër korridore ... militantë partiakë, në mesin e këtyre grupeve thuhet se është vërejtur edhe djali i kandidatit të PDK-së, Bekim Haxhiu. Domethënë, djali im i cili, sipas “Vetëvendosjes”, ka bërë probleme edhe më 12 dhjetor.

Të nderuar deputetë,

Ju dëshmoj përmes certifikatës së martesës dhe asaj familjare se djalë nuk kam. I kam dy vajza, njërën 8 vjeçare e tjetra 5 vjeç dhe jam i lumtur me to. “Vetëvendosja” dhe Albin Kurti qëllimisht shpifën, ngase kishin për qëllim ta dëmtojnë imazhin e zgjedhjeve të Kosovës, të dëmtojnë imazhin e kandidatëve të PDK-së, e ndër ta edhe timin. “Vetëvendosja” u mundua që përmes ankesave të shpifura ta zvarrisë procesin zgjedhor, me qëllim që vendi të mbetet sa më gjatë pa institucione, mu në kohën kur Kosovës i duheshin institucionet e konsoliduara, ngase Kosova po goditej nga Dick Marty dhe armiq të saj jashtë vendit, me të cilët Albin Kurti dhe “Vetëvendosja” u pajtuan në kohën kur po mbahej Asambleja e Evropës, e që Parlamenti ynë të ishte i formuar dhe të jepte qëndrimin e tij si organi më i lartë i këtij vendi. Edhe atëherë, edhe tani, ishte ky një proces i organizuar ankimor, një komplot kundër shtetit të Kosovës, me qëllim që të justifikohen humbjet.

Edhe sulmi i fundit ndaj rektorit të Universitetit të Prishtinës, duke rrezikuar shëndetin e tij, jep një sinjal që qartë se “Vetëvendosja” po i pengon institucionet e Kosovës dhe ato të dijes tani, ka për qëllim të tentojë të njollosë edhe institucionin më të lartë të dijes në Kosovë, Universitetin e Prishtinës.

Për shpifjet publike dhe tendencën për dëmtim të imazhit tim, si deputet deklaroj se ndaj subjektit “Vetëvendosje” do të ngre padi private për shpifje. Edhe një herë e pyes zotin Kurti – pse e ka refuzuar ta veshë uniformën e ushtarit të UÇK-së në Likovc? Ju faleminderit!

KRYETARI: Pyetjet nuk bëhen në këtë pikë të rendit të ditës.

Fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ne e kuptojmë sikletin e Qeverisë për mospasjen e buxhetit për këtë vit që kemi hyrë dhe i kuptojmë brengat dhe vështirësitë me të cilat po ballafaqohen qytetarët tanë. Këto, e dimë shumë mirë se vijnë si pasojë e vendimeve jo të ligjshme dhe të vendimeve për shkak të interesave të tyre individuale të Qeverisë së Kosovës në kohën e fushatës zgjedhore. Fjalën e kam për një kategori të caktuar, e cila është jashtëzakonisht e rëndësishme për fëmijët tanë, janë motrat e edukatoreve për të cilat e kam ngritur këtë çështje edhe një herë vitin e kaluar dhe, siç e dini, sot ato mbajnë greva dhe nuk mund t'i mësojnë fëmijët tanë për shkak të dështimeve të kësaj qeverie.

Zoti kryeministër, ju e dini shumë mirë që vitin e kaluar keni bërë një marrëveshje me këtë kategori, që është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe ajo marrëveshje tash e një vit nuk po respektohet. Cila është përgjigja apo cila është përgjigja e kësaj qeverie apo e ministrit të Arsimit, është rresht që një javë kjo grevë dhe ai as që ka shkuar të konsultohet dhe as ta shohë këtë kategori të edukatoreve, të cilat për juve nuk janë, po shihet se nuk janë shumë të rëndësishme, por për neve janë jashtëzakonisht të rëndësishme.

**KRYETARI:** Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Liburn Aliu, le të përgatitet deputetja e fundit e paraqitur, Xhevahire Izmaku.

**LIBURN ALIU:** I nderuari kryetar,

Të nderuar deputetë,

Tani në kohën kur Kosova është në një gjendje të rëndë, nga njëra anë ndodhi vrasja e Leutrim Musliut, bllokohen rrugët në veri, Kosova nis negociatat me Serbinë, duke e injoruar Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe nga ana tjetër kemi një krizë sociale, ku çmimet e artikujve elementarë janë rritur pothuaj dyfish dhe varfërimi është thelluar tej mase. Në këtë situatë pra, ajo që quhej gjiganti ekonomik i Kosovës, Kombinati “Trepça” është vendosur para likuidimit dhe i kërcënohet shitja, moment i përkryer që një gjë e tillë të realizohet pa u vërejtur. Njëjtë pati ndodhur edhe me gjigantin “Sharcem” në Elez Han, që u shitë muaj më parë nën hijen e zgjedhjeve të parakohshme.

Më datën 28 shkurt, Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës mori vendim për ta vendosur administrator ndërkombëtar për ndërmarrjen “Trepça”. Ky vendim u mor në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48, e cila nuk do të duhej të ishte në fuqi në Kosovë. Pas luftës “Trepça” është administruar nga UNMIK-u dhe AKM-ja, e tash nga AKP-ja.

Problemet kryesore të mosfunksionimit të saj ishin çështja e statusit të ndërmarrjes, e po ashtu edhe borxhi i supozuar ndaj kreditorëve të huaj në emër të kësaj ndërmarrjeje, që është rreth 200 milionë euro nga vitet '90. Këto konteste kanë bërë që në vitin 2005 kjo ndërmarrje të futet në moratorium. Gjendja e tillë statusore dhe mosinteresimi i qeverive të pasluftës ka kontribuar në degradimin dhe shkatërrimin e mëtejshëm të ndërmarrjes, sepse duke qenë me status të ngrirë, ajo thjeshtë është lënë pas dore.



Në vjeshtën e vitit 2007, ekspertë të USAID-it e kishin propozuar ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/48, me ç'rast "Trepça" do të shkonte në riorganizim, e jo në likuidim. Me këtë propozim ishte pajtuar Qeveria e Kosovës asaj kohe që administrimi i "Trepçës" të bëhej nga menaxhmenti i "Trepçës" dhe nën mbikëqyrjen e një gjykatësi nga Dhoma e Veçantë të Gjykatës Supreme. Ky do të ishte një shans për rivitalizimin e "Trepçës." Ishte pra në duar të Qeverisë e cila, në vend të bënte punën e saj përmes Ministrisë për Energji dhe Miniera, formoi një komision për këtë çështje dhe historia e rivitalizimit të "Trepçës" përmes riorganizimit të saj përfundoi me këtë komision.

Rimëkëmbja e "Trepçës" ka qenë e mundur për shkak të potencialit të madh zhvillimor të Kombinatit, kapaciteteve teknike-teknologjike dhe rezervave të mëdha të verifikuara të xehes së plumbit, zingut, argjendit, arit dhe kadmiumit e tjera. Vendimi për emërimin e administratorit të ri për "Trepçën" është marrë vetëm me qëllim të falimentimit të ndërmarrjes dhe pastaj privatizimit të saj, si dhe shlyerjen e borxheve të supozuara ndaj kreditorëve të huaj.

Lëvizja "Vetëvendosje" kundërshton çdo vendim për shitjen e pasurive kombëtare të vendit tonë. Jemi kundër privatizimit të ndërmarrjeve publike dhe pasurive strategjike të Kosovës, të cilat kanë potencial të madh....

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputetja e fundit është Xhevahire Izmaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni fillimisht t'i falënderoj të gjithë qytetarët që më dhanë mbështetjen dhe mundësinë që të jem zëri i tyre, këtu në Kuvendin e Kosovës dhe, me qenë se për herë të parë ju drejtohem nga foltorja e këtij Kuvendi, dua gjithashtu të bëj një falënderim për të gjitha ato gra dhe burra që nga ky Kuvend shpallën pavarësinë e vendit dhe na mundësuan të jemi deputetë të Republikës së pavarur të Kosovës.

Kolegë deputetë, me shumë interes kam përcjellë debatin tuaj rreth bisedimeve në mes të Republikës së Kosovës dhe asaj serbe. Unë e mbështes këtë dialog dhe Rezolutën për dialogun, sepse është vlerësuar dhe vlerësoj se është në interes të zhvillimeve pozitive integruese në rajon dhe është dialog që po mbështetet fuqishëm nga partnerët tanë ndërkombëtarë - SHBA dhe BE. Gjithashtu, ky dialog është përshëndetur dhe ka mbështetje edhe nga Tirana dhe vendet tjera fqinje, por mbi të gjitha është një dialog për çështje teknike që do të provojë t'i japë zgjidhje shumë problemeve që janë bërë pengesë për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Kolegë të nderuar,

Unë ju ftoj të mbështetni dialogun dhe në këtë rast edhe Qeverinë, kur gjithçka që do të bëhet në vazhdimësi, po bëhet për interesin e një jete më të mirë për qytetarët e vendit tonë.

Për t'u dhënë edhe një mesazh qytetarëve të vendit se jo gjithçka shihet bardh e zi nga ky Kuvend, më lejoni që të bëj dhe të përshëndes me një respekt të veçantë të gjithë pjesëtarët e Policisë së Kosovës për punën e tyre që po bëjnë, posaçërisht me rastin e arrestimit të të dyshuarve për kidnapimin e fëmijës para një jave, gjithashtu edhe të dyshuarit për vrasjen e Leutrimt.

Duke e ditur faktin se Kuvendi i Republikës së Kosovës është organi më reprezentativ i vendit dhe mbase gjuha e përdorur në të nga disa deputetë duhet të jetë e nivelit të tillë, unë kundërshtoj prejudikimet morale të disa deputetëve, posaçërisht të seancës së kaluar: Donika Kadaj- Bujupi, Glauk Koknjufca dhe Ardian Gjini, e cila ishte një gjuhë tipike, jo prezantative dhe e transferuar si instrument i një lufte për pushtet e jo një arsye për veprim politik.

Kuvendi i Kosovës nuk bën të tolerojë më gjuhën politike nga këta deputetë dhe të tjerët, të cilët në diskutimet e tyre e kanë dhënë etiketën e paargumentuar apo të pambylësë, të ndërtuar nga prejudikimet, spekulimet, fyerjet, sharjet të cilat nuk mund të zënë vend në këtë organ më të lartë legjislativ të vendit. Ta kursejmë qytetarin nga gjuha e zhurmës politike, të paargumentuar, në mënyrë që mos ta rrisim vargun e të zhgënjyerve nga politika.

Kosova nuk bën dhe nuk duhet lejuar të vishet në këtë petk dhe, në fund, një kërkesë njerëzore për të gjithë ne përfaqësues të qytetarëve që debatin dhe garën politike parlamentare ta orientojmë me argumente e jo në etiketime, etiketime mbiemrash, sepse ne nuk jemi këtu për t'u marrë me njëri - tjetrin, por për të krijuar politika, për zgjidhjen e problemeve të qytetarëve dhe zhvillimin e shtetit tonë të ri.

Dhe, në fund, një përshëndetje për shitjen e ndërmarrjes "LLamkos" ...

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputetët e kryen. Qeveria nëse do, mund ta shfrytëzojë kohën e vet. Nuk do. Vazhdojmë me rendin e ditës.

## **2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 3 mars 2011**

Pyes, a ka vërejtje në këtë procesverbal?

Nuk ka. Konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 3 mars 2011.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

## **3. Miratimi i Propozim-vendimit për formimin e komisioneve parlamentare**

Të nderuar deputetë,

Në pajtim me nenin 15, paragrafi 1 dhe nenin 63 të Rregullores së Punës të Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, i ka propozuar Kuvendit për miratim numrin dhe strukturën e komisioneve parlamentare.

Janë propozuar 13 komisione parlamentare, prej tyre 4 komisione të përhershme dhe 9 komisione funksionale.

Propozim-vendimi për numrin dhe strukturën e komisioneve parlamentare u është shpërndarë deputetëve.

Në bazë të nenit 81, paragrafi 3 të Rregullores së Kuvendit, ndryshimi i Rregullores së Kuvendit miratohet më 2/3 e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

Miratimi i vendimit për formimin e 4 komisioneve të përhershme dhe 9 komisioneve funksionale, nënkupton edhe ndryshimin e nenit 69, paragrafi 3 dhe 4 të Rregullores së Kuvendit, me të cilin nën janë caktuar 4 komisione të përhershme dhe 12 funksionale.

Radha është për kryetarët e grupeve parlamentare, nese e donë fjalën.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Xhevdet Neziraj.

**XHEVDET NEZIRAJ:** Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Kryeministër, zëvendëskryeministra dhe kolegë deputetë,

Do ta ngreh një çështje në lidhje me Komisionin për Interesat e Komunitetit dhe Kthim, ku në fund thuhet - një anëtar nga komuniteti egjiptian, hashkali ose goran. Unë nuk di se si është rregulluar, por kjo është një shkelje edhe e Rregullores dhe mund të them, pasi u shkelur dhe kemi shti në këtë Parlament – shkelje e lehtë e Kushtetutës dhe Rregullores, se është e shkruar 1/3 e shumicës, 1/3 e komunitetit serb dhe 1/3 e pakicës, atëherë është dashur që të jenë të përfaqësuar të gjitha komunitetet, për arsye se ky komision është filtër i të gjitha ligjeve dhe mbrojtjen e interesave të gjitha komuniteteve.

Unë shpresoj që disa komunitete të vogla edhe pse s'e kanë forcën aq të madhe politike, po dëshirojnë që të tregojnë atë forcën e vet. Këtu është bërë edhe një shkelje me rastin e zgjedhjes së anëtarit të Kryesisë nga radhët e komuniteteve jo serbe dhe jo shqiptare, ku nuk janë pyetur edhe 6 deputetë tjerë dhe është zgjedhur nga radhët e komunitetit turk, pa u pyetur edhe 6 tjerë, edhe këta 6 tjerë kanë pasur të drejtë të propozojnë. Ose të përdoret për të gjitha komisionet edhe për anëtarë të Kryesisë një rregull, ose mos të bëhet një shkelje e tillë. Tek e fundit, edhe në Komisionin për Komunitete, 4 pjesëtarë të komunitetit serb dhe të 4-tit janë gati të SLS-sit, le t'ua japin 1 dhe Partisë së Hashkalive, që është në kuadër të tyre, po edhe komunitetit goran, që është në kuadër të tyre.

Unë shpresoj që duhet të gjendet një zgjidhje dhe besoj se ky Kuvend do ta miratojë këtë propozim që po e propozoj.

KRYETARI: Faleminderit! Sa për njoftim, ne e kemi respektuar edhe Kushtetutën, kemi respektuar edhe dokumentin e presidentit Ahtisari, sipas të cilit është i formuar ky komision duke respektuar 1/3 dhe ky komision nuk përfaqësohet, nuk ka përfaqësim nga grupet parlamentare, se as komuniteti shumicë nuk përfaqësohet me gjithë grupet parlamentare, përfaqësohet me 4 deputetë. Komuniteti serb përfaqësohet me 4 deputetë dhe komunitetet tjera pakicë përfaqësohen me 4 deputetë.

Vendi i 12-të, ose anëtari i 12-të mund të bëhet sipas marrëveshjes së këtyre komuniteteve me rrotacion, që është një praktikë që është përdorur në të kaluarën për anëtarë të Kryesisë së Kuvendit nga komuniteti egjiptian ose hashkali ose goran. Do të thotë, edhe këto komunitete mund të jenë të përfaqësuara në këtë komision, por duke pasur një rrotacion.

Pastaj, ju e dini që e drejta e pjesëmarrjes në punën e komisionit është e të gjithë deputetëve që janë të interesuar të marrin pjesë, kështu që unë mendoj që e kemi respektuar, edhe një herë po them, edhe Kushtetutën, edhe ligjet që përcaktojnë këtë çështje.

Pra, dhamë sqarimet dhe vazhdojmë tash me procedurën e votimit.

Me kartela kemi 110 deputetë prezentë. Në fakt, kemi 112 deputetë prezentë. Lus deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Me 104 vota “për”, 6 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi vendimin për numrin, emërtimin dhe strukturën e komisioneve parlamentare. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

#### **4. Miratimi i Projektrezolutës për dialogun ndërmjet Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë**

Të nderuar deputetë,  
Ftoj përfaqësuesin e propozuesit të Projektrezolutës ta marrë fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, zoti kryetar!  
I nderuar kryeministër,  
Zëvendëskryeministra, ministra,  
Kolegë të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, në seancën e kaluar doli me një projektrezolutë. Pas debatit u vendos që grupet parlamentare – kryetarët e grupeve parlamentare t’i harmonizojnë qëndrimet e tyre. Ne kemi mbajtur dy takime me grupet – shefat e grupeve parlamentare, kemi bërë përpjekje që të gjejmë një gjuhë të përbashkët dhe ky dokument të jetë i përbashkët, por grupet e opozitës, AAK-së dhe LDK-së dhe “Vetëvendosjes” nuk e pamë të udhës të nënshkruajnë këtë dokument edhe pas inkorporimit të propozimit të tyre.

Unë sot edhe një herë do ta lexoj tekstin e rezolutës, me ndryshimet që janë bërë...

KRYETARI: Pra, i kanë deputetët, s'ka nevojë ta lexojmë tekstin e rezolutës. Ne debatin e kemi kryer, jemi në procedurë të votimit.

ADEM GRABOVCI: Atëherë, i lus deputetët që të përkrahim këtë projektrezolutë që do t'i japë Parlamentit të Kosovës një të drejtë të mbikëqyrë, përcjell rrjedhën e bisedimeve dhe të drejtën që për çdo rast të kërkojmë sqarime në Parlamentin e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatohet se me 63 vota "për", 48 "kundër", 1 abstenim, Kuvendi miratoi Rezolutën për dialogun ndërmjet Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë.

Dhe, me këtë ne e kemi përfunduar seancën e sotme, mirupafshim në seancën e ardhshme!

Përgatiti:

**Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës**